



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201500497/14

Tiranë ___/___/2016

Lënda: Rekomandohet ndërhyrja e organit që ju përfaqësoni mbi veprimtarinë e ZQRPP, Tiranë, si dhe ZVRPP, Tiranë, për zgjidhjen e çështjes së shtetases S.K.

Drejtuar : Ylli Manjani
Ministër i Drejtësisë

TIRANE

I nderuar Z.Manjani!

Në prill të Vitit 2015, Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar për shqyrtim çështjen e prezantuar prej shtetases S.K, me banim në Rruga "Qemal Stafa", nr.313, Tiranë, në të cilën shprehet shqetësimi i shkeljes të së drejtës së pronës së paluajtshme prej ZVRPP, Tiranë.

Referuar parashikimeve të kryera në Kreu III, "Regjistrimi i Pasurive të paluajtshme", neni 198, i Kodit Civil, në të cilin thuhet se; "Ministria e Drejtësisë administron veprimtarinë e regjistrimit publik për pasuritë e paluajtshme", si dhe kompetencat e dhëna organit që ju përfaqësoni, sipas parashikimeve të kryera në nenin 13, të ligjit nr.33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar, parashitë para jush çështjen e pranuar për shqyrtim prej Institucionit që unë përfaqësoj, dhe për të cilën shtetësja S.K, ka kërkuar dhe kërkon zgjidhjen e saj.

Nga hetimi administrative i kryer prej Institucionit të Avokatit të Popullit, lidhur me pretendimet e ankueses, ka rezultuar se ka cënim të të drejtës së pronës. Për këtë arsye Institucioni i Avokatit të Popullit, ka rekomanduar me shkresën nr. K3/S20-2 Prot, datë 17.06.2015, Regjistruetit të ZVRPP, Tiranë:

"Marrjen e nismës për karrigjimin e hartës kadastrale për pasurinë Nr.3/165, ZK 8150, Volum 32, Faqe 162", konform nenit 30 të ligjit nr.33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme", të ndryshuar, veprim i cili mundëson rivendosjen në vend të së drejtës së pronësisë së shkelur ankueses nga veprimtaria e parregullt e ZVRPP, Tiranë..

Në përgjigje të rekomandimit të dhënë, Regjistrueti i ZVRPP, Tiranë, me shkresën nr.23018/1 Prot, datë 23.11.2015, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit,

justifikon pa shkak të ligjshëm, mosmarrjen në konsiderat të rekomandimit të dhënë, duke vijuar në këtë mënyrë shkeljen e të drejtës së pronësisë, ankueses, mbi pasurinë, truallin me sipërfaqe 247m², regjistruar në bashkëpronësi të saj me ekstremitetet e lartpërmendura.

Ndodhur në këto kushte, referuar parashikimeve të nenit 23 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, është rekomanduar me Shkresën Nr. K3/S20-8 Prot, Datë 15.01.2016, Kryeregjistruesit të ZQRPP, Tiranë,

“Ushtrimi i kontrollit mbi veprimtarinë e ZVRPP, Tiranë, për zbatimin e legjislacioni, si dhe i gjithë detyrave për sigurimin e mirëfunksionimit, në çështjen e shtetases S.K”.

Edhe pse është kërkuar me shkresat nr.K3/S20-10 Prot, datë 29.03.2016, nr.K3/S20-12 Prot, datë 04.05.2016, apo Proces-verbalin datë 16.05.2016, të mbajtur me Përgjegjësen e Sektorit Juridik pranë ZQRPP, Tiranë, mundësimi i kthimit të përgjigjes për rekomandimin e dhënë, në afatin e parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, konstatohet se, përmbushja e detyrimit ligjor brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të shkresës nr. K3/S20-10 Prot, datë 29.03.2016, prej Kryeregjistruesit të ZQRPP, Tiranë, nuk ka ndodhur.

Gjithashtu, edhe pse Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira, pranë Ministrisë së Drejtësisë, me shkresat nr.S-65/1 Prot, datë 04.02.2016, nr.2436/1 Prot, datë 20.04.2016, dhe nr.3497/1 Prot, Datë 03.06.2016, ka përcjell për kompetencë, pranë ZQRPP, Tiranë, të rekomandimit të dhënë Asaj, përsëri Kryeregjistruesi I ZQRPP, Tiranë, nuk ka reaguar dhe reagon për kthimin e përgjigjes rreth rekomandimit të dhënë.

Përkundër kësaj situatë, si më sipër prezantuar, gjykojmë se, qëndrimi i Kryeregjistruesit të ZQRPP, Tiranë, është tregues i shkeljes së parimit të ligjshmërisë, transparencës, informimit, dhënies së ndihmës aktive, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjësisë, deburokratizimit dhe efijencës, sikurse parashikuar në nenet 4, 5, 6, 10, 13, 14, 15, dhe 18, të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të detyrueshme për zbatim në kuptim të parashikimeve të kryera në nenin 1 të këtij Kodi.

Situatën në të cilën ndodhet çështja e prezantuar e vlerësojmë jo në përputhje me parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës apo nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996 *“Pë ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”*.

Për arsyet e bëra të ditura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se; *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata Publike”*, si dhe nenit 22 dhe 23 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar,

REKOMANDOJMË

Ndërhyrjen e organit që ju përfaqësoni mbi veprimtarinë e ZQRPP, Tiranë, si dhe ZVRPP, Tiranë, për zgjidhjen e çështjes së shtetas S.K.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit, konform parashikimit të kryer në nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Bashkëlidhur ju dërgojmë,

Kopje të shkresës nr. K3/S20-8 Prot, datë 15.01.2016, të Avokatit të Popullit, drejtuar Kryeregjistuesit të ZQRPP, Tiranë.

Kopje të shkresës nr. K3/S20-10 Prot, datë 29.03.2016, të Avokatit të Popullit, drejtuar Kryeregjistuesit të ZQRPP, Tiranë.

Kopje të shkresës nr. K3/S20-12 Prot, datë 04.05.2016, të Avokatit të Popullit, drejtuar Kryeregjistuesit të ZQRPP, Tiranë.

Kopje të Proces-verbalit datë 16.05.2016, të mbajtur me Përgjegjshen e Sektorit Juridik pranë ZQRPP, Tiranë.

Kopje të shkresës S-65/1 Prot, datë 04.02.2016, të Drejtorisë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira, pranë Ministrisë së Drejtësisë, drejtuar Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr.2436/1 Prot, datë 20.04.2016, të Drejtorisë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira, pranë Ministrisë së Drejtësisë, drejtuar Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës 2436/1 Prot, datë 20.04.2016, të Drejtorisë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira, pranë Ministrisë së Drejtësisë, drejtuar Avokatit të Popullit.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI